

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Isa Kelmendi dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Xh. M., nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës – Sh.a.-Divizioni i Rrjetit në Prishtinë, për shkak të shpërblimit të dëmit material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2088/2014 datë 15.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8.4.2019, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2088/2014 datë 15.11.2018.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 2216/2007 datë 25.11.2013, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që në emër të dëmit material të shkaktuar më datë 7.9.2007, t'ia paguajë për objektin ndërtimor shumë prej 2.944,21 €, dhe për dëmin në prodhime bujqësore si grurë, elb, sanë dhe jonxhë shumë prej 4.346,00 €, gjithsej 7.290,21 €, me kamatë në lartësi prej 3,5% sipas mjeteve të deponuara mbi një vit që nga dita e ushtrimit të padisë, datë 18.10.2007, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 973,00 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2088/2014 datë 15.11.2018, është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që i referohet kërkesës kryesore të paditësit për kompensimin e dëmit material, ndërsa është ndryshuar i njëjti aktgjykim në pjesën që i referohet kamatës së gjykuar ashtu që paditësit për shumë prej 2.944,21 € (për objektin ndërtimor) i pranohet kamata që nga data 21.7.2013, ndërsa për shumë prej 4.346,00 € (për prodhimet bujqësore të djegura) i pranohet kamata që nga data 29.7.2013, të cilën e pranojnë bankat e Kosovës në mjetet e afatizuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 7.9.2007, pas mesnatës, si pasojë e zjarrit të shkaktuar nga energjia elektrike, në depon e paditësit e cila është e ndarë prej shtëpisë së tij ishte shkaktuar zjarr me ç'rast kjo depo ishte djegur së bashku me prodhimet bujqësore të gjendura në të si grurë, elb, sanë dhe jonxhë, se paditësi konsideron që e paditura është përgjegjës për shkaktimin e këtij dëmi dhe rrjedhimisht edhe për kompensimin e tij, kurse e paditura pretendon se nuk është përgjegjës për shkaktimin e këtij zjarri dhe dëmin e shkaktuar në pronën e paditësit. Ditën që është shkaktuar zjarri paditësi e ka njoftuar të paditurën me kërkesë për dalje në vend të ngjarjes, mirëpo askush prej të paditurës nuk kanë dal për të shikuar e konstatuar fakte relevante rreth shkaktimit të këtij zjarri, ndërsa inspekcioni i parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit pranë Drejtorisë për Mbrojtje Civile dhe Emergjente në Komunën e Prishtinës kanë dalë në vend të ngjarjes ku kanë konstatuar se supozohet që zjarri ka shpërthyer si pasojë e tensionit të pakontrolluar gjatë punimeve në trafo stacionin e këtij lokaliteti gjatë ditës dhe ndërprerjeve-kyçjeve të pakontrolluara. Ndër të tjera inspekcioni në fjalë ka konstatuar se dëmet materiale nga zjarri në depo janë afër 5.000,00 €.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë në bazë të ekspertizës të ekspertit të elektros Prof.Dr.R.S. ka konstatuar se zjarri ka ardhur si pasojë e energjisë elektrike me fajin ekskluziv të paditurës e cila me rastin e dhënies së pëlqimit nga kompetentët e saj – paditësit për kyqjen e shtëpisë së tij të banimit, bashkë me objektet përcjellëse të saj, në rrjetin e energjisë elektrike, e cila gjendet në fshatin ..., (të cilat janë furnizuar nga i njëjti kuadër elektrik shpërndarës i pajisur me siguresa automatike), nuk ka bërë inspektimin e tërësishëm të instalimit elektrik në objektin e banimit por edhe në objektet ndihmëse, duke e kyçur të njëjtin në rrjetin e konsumatorit, pa i përfillur parametrat e përcaktuar dhe pa u plotësuar kushtet e parapara për kyçje në kuptim të nenit 30 lidhur me nenin 31 dhe 25 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 2004/10. Në anën e të paditurës ka edhe shumë lëshime tjera të identifikuara nga gjykata e shkallës së parë në bazë të ekspertizës së elektros, e që si rezultat i tyre ka ndodhur zjarri në pronën e paditësit, prandaj gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se barra e përgjegjësisë për

kompensimin e dëmit bie në të paditurën në pajtim me nenin 154 paragrafi 1 dhe 173 të LMD.

Lartësinë e dëmit të shkaktuar gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës së ndërtimtarisë të Ing. i dipl.S. B., të datës 21.7.2013 dhe ekspertizës nga lëmi i bujqësisë të Ing. i dip. A.S., të datës 29.7.2013 të cilat ekspertiza gjykata e shkallës së parë i ka aprovuar si të bazuara duke pasur parasysh se janë dhënë sipas rregullave të profesionit përkatës dhe në asnjë mënyrë mendimet e konstatimet e këtyre ekspertëve nuk janë vënë në dyshim. Rreth sasisë së prodhimeve bujqësore të gjendura në depon e paditësit, e të përfshira me zjarr, gjykata e shkallës së parë i ka besuar specifikacionit me shkrim të paditësit në shkresat e lëndës i cili është në pajtim edhe me konstatimin e Inspektionit Komunal për parandalimin dhe hulumtimin e zjarrit i paraqitur në raportin e këtij inspektioni nr. ..., datë ..., ku është konstatuar se nga ky zjarr ishte dëmtuar një sasi e madhe e ushqimit për bagëti si sanë, jonxhë, tërshërë, misër dhe grurë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës sa i përket kërkesës kryesore të paditësit për kompensimin e dëmit material në të cilën pjesë ka vërtetuar aktgjykimin e lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë. Aktgjykimin e lartpërmendur e ka ndryshuar vetëm sa i përket kamatës duke ia njohur paditësit kamatën përkatëse me fillim që nga dita e nxjerrjes së dy ekspertizave të përshkruara më lartë.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e tyre nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme vlerësoi pretendimin e revizionit për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.2 pika n, të LPK, sipas të cilave provat e administruara nuk mbështesin një dispozitiv të tillë të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë ngase janë të dyshimta dhe të njëanshme, dhe është befasuar se si gjykata mbështet aktgjykimin e saj në prova të tilla, më tutje, se gjykata e shkallës së parë bënë seleksionimin e provave dhe nuk përfill asnjë vërejtje të propozuar nga ana e të paditurës dhe në këtë mënyrë duke u munduar të arsyetoj një veprim të tillë, dispozitivin e aktgjyimit e bie në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat e lëndës. Këto pretendime të revizionit Gjykata Supreme e

Kosovës i refuzoi si të pabazuara, kjo ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë mbështetet në prova të cilat nga ana e të paditurës kontestohen pa vend, fjala është për tri ekspertizat e përshkuara më lartë, të cilave me të drejtë të dy gjykatat e lartpërmendura iu kanë kushtuar besim të plotë, për arsye se edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme ato ekspertiza janë në tërësi profesionale, dhe të dhëna nga ekspertët shumë profesional, sidomos ekspertiza e elektros lidhur me shkakun e shkakimit të zjarrit që është e dhënë nga një prof.dr. i lamisë përkatëse në Universitetin e Prishtinës. E paditura as që ka kërkuar ekspertiza tjera apo super ekspertiza në drejtim të vërtetimit të shkakut dhe lartësisë së dëmit të shkakuar. Qëndron fakti se këto ekspertiza janë bërë pas një kohe të konsiderueshme pas shkakimit të dëmit, mirëpo të njëjtat janë bërë në bazë të shkresave dhe provave të lëndës dhe në bazë të vend shikimit, kështu që me pretendimet e revizionit nuk mund të vihet në pyetje saktësia dhe besueshmëria e tyre.

Për këto arsye Gjykata Supreme vlerëson se të dy gjykatat e lartpërmendura në mënyrë të drejt kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit, kurse pretendimet e të paditurës se ajo nuk është përgjegjëse për shkakimin e dëmit e as e detyruar për kompensimin e tij, vlerësohen si një tentim i paarsyeshëm i saj për ikje nga përgjegjësia ligjore që ka si bartëse e veprimtarisë së rrezikshme siç është distribuimi i energjisë elektrike.

Pasi që me pretendimet e revizionit nuk mund të vihet në pyetje aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, revizioni i të paditurës u refuzua si i pabazuar.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.118/2019, më 8.4.2019

Kryetari i kolegjit,

Shukri Sylejmani